



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 shkurt 2021
Nr. ref.:RK 1715/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI128/19

Parashtrues

Artan Mala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pml.
nr. 44/2019 të 4 marsit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Artan Mala (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës) nga Gjakova, cili aktualisht është duke vuajtur dënimin me burg në Burgun e Dubravës në Istog, të cilin e përfaqëson avokati Korab Bokshi nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme PML. nr. 44/2019, të 04 marsit 2019, me të cilin është refuzuar kërkesa e tij për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit PA. 1. nr. 800/18 të 18 tetorit 2018.
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 prill 2019.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe të drejtat e garantuara me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 gusht 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 20 gusht 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.
8. Më 28 gusht 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës, të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme dhe kërkoi nga ajo një kopje të fletëkthesës, me datën kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin PML. nr. 44/2019 të 4 marsit 2019.
9. Më 12 shtator 2019, Gjykata Supreme dorëzoi në Gjykatë vërtetimin me të cilin dëshmohet se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme PML. nr. 44/2019 i ishte dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 18 prill 2019.
10. Më 20 janar 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Gjatë vuajtjes së dënimit me burg në Burgun e Dubravës në Istog, më 2 maj 2014, parashtruesi i kërkesës e sulmoi fizikisht personin K.I, gjithashtu person nën kujdestari të burgut të lartpërmendur, dhe i shkaktoi lëndime të rënda trupore.
12. Më 27 tetor 2014, Prokuroria Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Pejë (në tekstin e mëtejme: Prokuroria) ngriti Aktakuzën PP/II nr. 981/14 kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar se ai ka kryer veprë penale dhe atë veprën penale të *“lëndimit të rëndë trupor”*.
13. Më 13 qershor 2018, Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) mbajti një seancë përgatitore gjatë së cilës ishin të pranishëm Prokurori dhe parashtruesi i kërkesës, përkatësisht i akuzuari, me ç’rast parashtruesi vullnetarisht pranoi fajin.
14. Gjatë seancës përgatitore të Gjykatës Themelore, u arrit edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë.
15. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin P. nr. 285/14, me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat ai akuzohet në bazë të një marrëveshje për pranimin e fajësisë, dhe i shqiptoi dënimin unik me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.
16. Në arsyetimin e aktgjykimit, Gjykata Themelore deklaroi: *“Gjykata konstaton se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pa ndonjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë të pranimin të fajësisë si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248, par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal e aprovon deklarin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.”*
17. Në një datë të pacaktuar, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore, për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke propozuar që Gjykata e Apelit ta pranojë ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar si dhe që i mbrojturi i tij të lirohet nga dënimi. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës deklaroi: *„se ishte shkelur e drejta e të mbrojturit të tij në mbrojtje pasi që të njëjtit nuk iu është caktuar mbrojtës edhe pse i njëjti ka qenë në vuajtje të dënimit dhe në këtë mënyrë i është cenuar e drejta fundamentale, e drejta në mbrojtje përkatësisht e drejta për mbrojtje efektive në çështje penale“*.
18. Më 18 tetor 2018, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin PA. 1. nr. 800/2018, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, duke deklaruar:

„Nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit të të akzuarit se të mbrojturit të tij i është shkelur e drejta në mbrojtje ngase vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur penalisht përgjegjës dhe fajtor nuk paraqet mbrojtje të detyruar ashtu siq parashihet me dispozitën e nenit 53 të KPK-

ës. Gjate shqyrtimit gjyqësor i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në cilësi të pandehurit është njoftuar edhe me të drejtën e tij që të angazhoj mbrojtës dhe se është paralajmëruar se në raste se nuk ka mundësi ekonomike që të angazhoj mbrojtës atëherë të njëjtit do ti caktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare e drejtë kjo e paraparë me dispozitën e nenit 58 par. 1 të KPK-ës pas këtij njoftimi i akuzuari ka deklaruar se mbrojtjen dua ta jepi vete dhe se nuk dëshiroj mbrojtës, dhe se gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi që është njoftura me mundësinë ligjore të deklarimit rrethe fajësisë i njëjti ka pranuar fajësinë dhe se gjykata me aktvendim te posaçëm e ka aprovuar pranimin e fajësisë se të akuzuarit pasi që janë plotësuar kushtet ligjore nga dispozita e nenit 248 të KPK-ës.

[...]

Mbrojtësi i të akuzuarit në ankesën e tij pretendon se matja e dënimit me aktgjykimin e atakuar është e gabuar. Gjykata ka pasur informacion se i akuzuari është i dënuar me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Pejë P. nr. 80/06 të datës 23.-6.2016, pjesërisht i vërtetuar dhe pjesërisht i ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës AP. nr. 582/2006 të datës 19.04.2017 dhe se nuk është bere unifikimi i dënimeve dhe se me këtë rast gjykata e shkallës së parë ka vepruar në kundërshtim me nenin 82 lidhur me nenin 80 par. 2.2 të KPRK-ës.

Pretendimet e lartcekura të mbrojtësit të të akuzuarit kjo gjykatë i vlerëson si të pa bazuara. Sipas shkresave të lëndës dhe atë nga arsyetimi i vendimit nuk del se gjykata e shkallës së parë të e ketë patur kopjen e aktgjykimeve me te cilat mbrojtësi pretendon se i mbrojturi i tij ka qenë i dënuar e po ashtu edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk shihet se vetë i akuzuari të ketë kërkuar bashkimin e dënimeve ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 82 dhe 80 të KPRK-ës, në mungesë të këtyre aktgjykimeve dhe kërkesës së vetë të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor gjykata e shkallës së parë nuk ka pasur mundësi ligjore që të bëjë bashkimin e dënimeve. Një kërkesë të tillë i akuzuari duhet ta bëjë në gjykatën e shkallës së parë aty ku edhe i është shqiptuar dënimi i fundit ashtu siq parashihet edhe me dispozitën e nenit 82 të KPRK-ës.“

19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit.
20. Më 4 mars 2019, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin PML. nr. 44/2019, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar. Në Aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme theksoi që:

„Është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe atë pas udhëzimeve të dhëna në këtë seancë, ashtu që në faqen e dytë të procesverbalit të shqyrtimit fillestar është konstatuar se i dënuari ka deklaruar se mbrojtjen do ta jep personalisht dhe nuk dëshiron mbrojtës. Për më tepër, edhe pse sipas kualifikimit ligjor të veprës penale në aktakuzë, në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet për mbrojtje obligative, megjithatë i dënuari është udhëzuar nga gjyqtari i çështjes së gjykatës së shkallës së parë përkitazi me të drejtën e caktimit e mbrojtësit me shpenzime publike, sipas kërkesës së tij e në rastin konkret i dënuari nuk ka paraqitur një kërkesë të tillë. Në rastin konkret gjykata e shkallës

së parë duke u bazuar edhe në deklarinimin e të dënuarit gjatë shqyrtimit fillestar ka zhvilluar një gjykim të drejtë dhe të ligjshëm dhe të dënuarit i ka dhenë mundësi të mjaftueshme ligjore për të zgjedhur mbrojtësin, por i dënuari ka deklaruar se nuk dëshiron të angazhojë mbrojtës dhe meqenëse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për mbrojtje të detyruar siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 të KPPK-së nuk i është caktuar mbrojtje sipas detyrës zyrtare për më tepër, i dënuari nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtës me shpenzime publike, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 58 të KPPK-së, edhe pse ka qene i njoftuar për këtë mundësi.

[...].

Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe nuk ka bërë shkelje e cila pretendohet për shqiptimin e dënimit unik, përkatësisht që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim unik për veprën penale të vrasjes së rëndë (për të cilën është në vuajtje të dënimit) dhe veprës penale lëndimi i rënde trupor për të cilën është gjykuar, meqë në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me veprën penale të lëndimit të rëndë trupor ende nuk e kishte marrë formën e prerë, ashtu që nuk mund të shqiptohet dënim unik në rastet kur të dy aktgjykimet nuk e kanë formën e prerë, siç rezulton në rastin konkret“.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës konsideron që në tërësi, procedura gjyqësore e zhvilluar në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme, në aspektin procedural dhe material, ishte e padrejtë, sepse i ishte shkelur e drejta e mbrojtjes, përkatësisht nuk iu caktua një mbrojtës në procedurën e shkallës së parë, gjë që rezultoi në shkeljen e parimit të barazisë së palëve në procedurë.
22. Parashtruesi më tej konsideron se me vendimin e kontestuar atij i ishte shqiptuar dënim me burg, i matur gabimisht sepse nuk ishte bërë mbledhja e dënimit së bashku me procedurën e mëparshme penale kundër tij.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon që si rezultat i kësaj janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, si dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
24. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të konstatojë që gjykimi pa avokat në procedurën e shkallës së parë si dhe matja e gabuar e dënimit të shqiptuar përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese, si dhe të drejtave dhe lirive të garantuara me KEDNJ.
25. Parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata t'i prishë të gjitha aktgjykimet dhe ta kthejë çështjen në rigjykim.

Dispozitat përkatëse ligjore

KODI I PROCEDURËS PENALE i 13 dhjetorit 2012

KAPITULLI V MBROJTËSI

Neni 53

E drejta e të pandehurit për të pasur mbrojtës [...]

3. Nga e drejta për të pasur mbrojtës mund të hiqet dorë, përveç në rastin e mbrojtjes së detyruar, nëse heqja dorë bëhet qartë dhe vullnetarisht pas informimit të plotë për të drejtën e tij në mbrojtje. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i dyshuari apo i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose mund të bëhet gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës verifikohet nga gjykata.

[...]

Neni 57

Mbrojtësi në rastet e mbrojtjes së detyruar [...]

1.3 nga ngritja e aktakuzës, kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale të dënueshme me të paktën dhjetë vjet burgim;
[...]

Neni 58

Mbrojtësi me shpenzime publike, kur mbrojtja nuk është e detyruar

1. Kur nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtjen e detyruar, të pandehurit i caktohet mbrojtës me shpenzime publike me kërkesën e tij, nëse: 1.1 nuk ekzistojnë kushtet për mbrojtje të detyrueshme e procedura penale zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burgim me tetë (8) ose më shumë vjet;.

KODI PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

nr. 04/L-082

i 20 prillit 2012

MATJA E DËNIMIT

[...]

Neni 80

Dënimi për bashkim të veprave penale

1. Nëse kryesi me një apo me më shumë veprime kryen disa vepra penale për të cilat gjykohet në të njëjtën kohë, gjykata së pari shpall dënime për secilën

nga këto vepra, e pastaj për të gjitha këto vepra e shqipton dënimin unik.

2. Gjykata shqipton dënimin unik sipas këtyre rregullave:

2.1. nëse për ndonjëherë prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm, atëherë e shqipton vetëm këtë dënim;

2.2. nëse për secilën prej veprave penale gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh;

2.3. nëse gjykata e ka shqiptuar dënimin me burgim deri në tri (3) vjet për secilën nga veprat penale, dënimi unik me burgim nuk mund të jetë më i lartë se tetë (8) vjet;

2.4. nëse gjykata ka shqiptuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale, dënimi unik me gjobë është shuma e dënimeve të shqiptuara por nuk mund të tejkalojë shumën prej njëzet e pesë mijë (25.000) Euro, përkatësisht pesëqind mijë (500.000) Euro kur një apo shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore;

2.5. nëse gjykata për disa vepra penale ka shqiptuar dënime me burgim, ndërsa për vepra të tjera ka shqiptuar dënimin me gjobë, gjykata shqipton dënim unik me burgim dhe me gjobë, në pajtim me nën-paragrafët 2.1. deri 2.4. të këtij paragraf.

3. Gjykata shqipton dënimin plotësues nëse është shqiptuar së paku për një nga veprat penale të parapara në nën-paragrafin 2.4. të paragrafit 2. të këtij neni.

[...]

Neni 82

Llogaritja e dënimit të personave të dënuar

1. Nëse personi i dënuar gjykohet për vepër penale të kryer para se të ketë filluar mbajtjen e dënimit të shqiptuar me një dënim të mëparshëm, apo për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, gjykata shqipton dënimin unik për të gjitha veprat penale (neni 80 i këtij Kodi), duke marrë parasysh dënimin e shqiptuar më parë. Dënimi ose pjesa e dënimit të cilin personi i dënuar e ka mbajtur llogaritet në dënimin e shqiptuar unik.

2. Për vepër penale të kryer gjatë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, gjykata ia cakton dënimin kryesit pavarësisht nga dënimi i shqiptuar më parë nëse zbatimi i dispozitave të nenit 80 të këtij Kodi nuk do ta arrinte qëllimin e dënimit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e pjesës së pa mbajtur të dënimit të shqiptuar më parë.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

26. Gjykata shqyrton nëse kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

27. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

28. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu thirret në kriteret e pranueshmërisë, të cilat janë të parapara me Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.

29. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Pml. nr. 44/2019] të 4 marsit 2019, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të parapara me ligj.
30. Parashtruesi gjithashtu deklaroi të drejtat dhe liritë themelore të cilat pretendohet se janë shkelur në pajtim me kushtet nga neni 48 i Ligjit dhe e parashtrroi kërkesën në përputhje me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
31. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të

Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) parasheh në mënyrë specifike:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

32. Parashtruesi, siç u cek më lart, pretendon para Gjykatës se janë shkelur nenet 22, 30, 31 dhe 53 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
33. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës, Gjykata, duke pasur parasysh përmbajtjen dhe kuptimin e neneve 22 dhe 53 të Kushtetutës, deklaron se gjatë përcaktimit të bazueshmërisë së shkeljeve të lartcekura do të marrë parasysh të gjithë mekanizmat dhe instrumentet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, dhe në pajtim me këtë do të zbatojë të gjitha garancitë e përgjithshme dhe të veçanta, si dhe parimet e parapara në nenet 22 dhe 53 të Kushtetutës, të cilat janë të zbatueshme në rastin konkret.
34. Gjykata së pari rikujton se Gjykata Themelore në Pejë me Aktgjykimin [P. nr. 285/14], në bazë të një marrëveshje për pranimin e fajësisë, e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e një veprë penale. Pas ankesës së parashtruesit, Gjykata e Apelit refuzoi ankesën e parashtruesit, duke vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Po ashtu, Gjykata Supreme e refuzoi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si të pabazuar.
35. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimi i kontestuar ishte marrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi ankohet që në rastin e tij ka pasur shkelje të neneve 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak zbatimit të gabuar të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPRK) dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPRK) nga gjykatat e rregullta. Parashtruesi i kërkesës pretendon se për shkak të faktit që nuk iu caktua një përfaqësues ligjor sipas detyrës zyrtare në procedurën e shkallës së parë dhe nga fakti që gjatë matjes së dënimit atij nuk iu shqiptua dënimi unik, ligji nuk u zbatua në mënyrë adekuate, gjë që çoi në shkeljet e mësipërme të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së.
37. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës paraqiti pretendimet e njëjta edhe në gjykatat e rregullta.
38. Në këtë aspekt, Gjykata fillimisht thekson se në kontekstin e vlerësimit të pajtueshmërisë së procedurave gjyqësore me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), praktikën gjyqësore të

Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (Shih rastet e Gjykatës, KI104/16, parashtrues *Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

39. Përveç kësaj, në kontekst të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, Gjykata rikujton që thelbi i pretendimeve ndërlidhet me pretendimin për interpretim të gabuar të KPPRK-së dhe KPRK-së, interpretim ky i cili, sipas parashtruesit të kërkesës, ka rezultuar në mohimin e të drejtës për mbrojtje dhe përcaktimin e gabuar të dënimit të shqiptuar.
40. Në kontekst të pretendimit që ndërlidhet me interpretim të gabuar të ligjit të aplikueshëm, Gjykata fillimisht thekson se si rregull i përgjithshëm, pretendimet për interpretimin e gabuar të ligjit që pretendohet të jetë bërë nga gjykatat e rregullta, kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla, nuk janë në juridiksionin e Gjykatës, dhe për këtë arsye, në parim, Gjykata nuk mund të shqyrtojë ato. (shih rastet e Gjykatës: nr. KI06/17, parashtrues *L.G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 36; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 30 majit 2018, paragrafi 56; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, parashtrues të kërkesës, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Barbas"*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 gushtit 2019, paragrafi 60).
41. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (*ligjshmëria*), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (*kushtetutshmëria*). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "*shkallës së katërt*", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih rastin e GJEDNJ-së, *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28; dhe shih, gjithashtu ndër të tjera, rastet e Gjykatës: KI06/17, cituar më lart, paragrafi 37; dhe KI122/16, cituar më lart, paragrafi 57; dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafi 61).
42. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e që në mënyrë të qartë thekson se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Pronina kundër Rusisë*, Aktgjykim i 30 qershorit 2005, paragrafi 24; dhe rastet e Gjykatës KI06/17, cituar më lart, paragrafi 38; KI122/16, cituar në tekstin më lart, paragrafi 58 dhe KI154/17 dhe 05/18, cituar në tekstin më lart, paragrafi 62).

43. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. GJEDNJ ka theksuar se përderisa autoritetet vendore, përkatësisht gjykatat, kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me KEDNJ-në. (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, Aktgjykim i 25 majit 2000, paragrafët 33-39).
44. Rrjedhimisht, edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmarrë masa kur vëren se një gjykatë ka *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi arbitrare”* në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës (përkitazi me parimet themelore në lidhje me interpretimin dhe aplikimin qartazi të gabuar të ligjit, shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI154/17 dhe 05/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty).
45. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar para Gjykatës: (i) arsyet të cilat do të mund të mbështesin pretendimin se në rrethanat e rastit konkret, KPPRK-ja dhe KPRK-ja janë interpretuar nga gjykatat e rregullta në *“mënyrë qartazi të gabuar”*; dhe (ii) se si një interpretim i tillë, ka rezultuar në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës.
46. Gjykata megjithatë vëren se në kontekst të pretendimeve të tij për interpretim të gabuar të KPPRK-së, parashtruesi i kërkesës pretendon që në procedurën e shkallës së parë atij është dashur t'i caktohej një përfaqësues sipas detyrës zyrtare, dhe se gjykatat e rregullta kanë interpretuar gabimisht KPRK-në dhe për këtë arsye nuk i llogaritën atij dënimin unik me rastin e shqiptimit të dënimit me burg.
47. Në këtë drejtim, Gjykata së pari vëren se pretendimet e parashtruesit në lidhje me interpretimin e KPPRK-së dhe KPRK-së janë shqyrtuar dhe arsyetuar nga gjykatat e rregullta, së pari nga Gjykata Themelore me Aktgjykimin [P. nr. 285/14] të 13 janarit 2018, si në vijim:

“...Gjykata konstaton se i pandehuri pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, pa ndonjë presion. I pandehuri është i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë të pranimin të fajësisë si dhe të gjitha kërkesat nga neni 248, par. 1 të KPPRK-së janë përmbushur. Ashtu që gjykata me aktvendim në procesverbal e aprovon deklarinimin për pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit”.
48. Gjykata gjithashtu vëren se në procedurën e apelit, parashtruesi i kërkesës u përfaqësua nga një avokat, ndaj pretendimeve të të cilit në lidhje me shkeljen e së drejtës për mbrojtje për shkak të mosangazhimit të mbrojtësit sipas detyrës zyrtare, Gjykata e Apelit u përgjigj, *„Nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se të mbrojturit të tij i është shkelur e drejta në mbrojtje ngase vepra penale për të cilën i akuzuari është shpallur penalisht përgjegjës dhe fajtor nuk paraqet mbrojtje të detyruar ashtu siq parashihet me dispozitën e*

nenit 53 të KPK-ës. Gjate shqyrtimin gjyqësor i akuzuari është njoftuar me të drejtat e tij në cilësi të pandehurit është njoftuar edhe me të drejtën e tij që të angazhoj mbrojtës dhe se është paralajmëruar se në raste se nuk ka mundësi ekonomike që të angazhoj mbrojtës atëherë të njëjtit do ti caktohet mbrojtës sipas detyrës zyrtare e drejtë kjo e paraparë me dispozitën e nenit 58 par. 1 të KPK-ës pas këtij njoftimi i akuzuari ka deklaruar se mbrojtjen dua ta jepi vete dhe se nuk dëshiroj mbrojtës“.

49. *Sa i përket aplikimit të KPRK-së, përkatësisht arsyet pse gjykata e shkallës së parë nuk e llogariti dënimin unik në pajtim me nenet 80 dhe 82 të KPRK-së, Gjykata e Apelit u përgjigj, „Sipas shkresave të lëndës dhe atë nga arsyetimi i vendimit nuk del se gjykata e shkallës së parë të e ketë patur kopjen e aktgjykimeve me te cilat mbrojtësi pretendon se i mbrojturi i tij ka qenë i dënuar e po ashtu edhe nga procesverbali i shqyrtimit gjyqësor nuk shihet se vetë i akuzuari të ketë kërkuar bashkimin e dënimeve ashtu siç kërkohet me dispozitën e nenit 82 dhe 80 të KPRK-ës, në mungese të këtyre aktgjykimeve dhe kërkesës së vetë të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor gjykate e shkallës së parë nuk ka pasur mundësi ligjore që të bëjë bashkimin e dënimeve. Një kërkesë të tillë i akuzuari duhet ta bëjë në gjykatën e shkallës së parë aty ku edhe i është shqiptuar dënimi i fundit ashtu siq parashihet edhe me dispozitën e nenit 82 te KPRK-ës “.*
50. *Përveç kësaj, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin (Pml. nr. 44/2019 të 4 marsit 2019), vërtetoi dhe mbështeti aktgjykimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke iu përgjigjur në mënyrë të detajuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke arsyetuar „Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë duke u bazuar edhe në deklarimin e të dënuarit gjatë shqyrtimit fillestar ka zhvilluar një gjykim të drejtë dhe të ligjshëm dhe të dënuarit i ka dhenë mundësi të mjaftueshme ligjore për të zgjedhur mbrojtësin, por i dënuari ka deklaruar se nuk dëshiron te angazhoj mbrojtës dhe meqenëse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për mbrojtje të detyruar siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 të KPPK-së nuk i është caktuar mbrojtje sipas detyrës zyrtare për më tepër, i dënuari nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtës me shpenzime publike, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 58 të KPPK-së, edhe pse ka qene i njoftuar për këtë mundësi. [...] Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe nuk ka bërë shkelje e cila pretendohet për shqiptimin e dënimit unik përkatësisht që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim unik për veprën penale të vrasjes së rëndë (për të cilën është në vuajtje të dënimit) dhe veprës penale lëndimi i rënde trupor për të cilën është gjykuar, meqë në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me veprën penale të lëndimit të rëndë trupor ende nuk e kishte marrë formën e prerë, ashtu që nuk mund të shqiptohet dënimi unik në rastet kur të dy aktgjykimet nuk e kanë formën e prerë, siç rezulton në rastin konkret”.*
51. *Në bazë të arsyeve të lartcekura, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta iu përgjigjën pretendimit të parashtruesit të kërkesës në lidhje me zbatimin e gabuar të ligjit, përkatësisht në lidhje me procedurën për caktimin e përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare dhe llogaritjen e dënimit unik. Gjykatat e rregullta i vlerësuan këto pretendime si të pabazuara dhe konstatuan se e*

drejta materiale ishte zbatuar në mënyrë të drejtë, duke arsyetuar se *“meqenëse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për mbrojtje të detyruar siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 57 të KPPK-së nuk i është caktuar mbrojtje sipas detyrës zyrtare për më tepër, i dënuari nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtës me shpenzime publike, siç është përcaktuar me dispozitën e nenit 58 të KPPK-së, edhe pse ka qenë i njoftuar për këtë mundësi. [...] Gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar ligjin penal dhe nuk ka bërë shkelje e cila pretendohet për shqiptimin e dënimit unik përkatësisht që ndaj të dënuarit të shqiptohet dënim unik për veprën penale të vrasjes së rëndë (për të cilën është në vuajtje të dënimit) dhe veprës penale lëndimi i rëndë trupor për të cilën është gjykuar, meqë në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përkitazi me veprën penale të lëndimit të rëndë trupor ende nuk e kishte marrë formë e prerë”*.

52. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se nuk ka asgjë që tregon se gjykatat e rregullta kanë *“aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar”*, aplikim i cili do të mund të rezultonte në *“konkluzione arbitrare”* apo *“qartazi të paarsyeshme”* për parashtruesin e kërkesës.
53. Prandaj, duke marrë parasysh sqarimet e lartcekura, Gjykata thekson se pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me zbatimin e gabuar të KPPRK-së dhe KPRK-së ishin trajtuar dhe sqaruar nga gjykatat e rregullta, dhe se nga procedura në tërësi, nuk rezulton se gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo kanë interpretuar ligjin e aplikueshëm në mënyrë arbitrare (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës, KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 nëntorit 2019, paragrafi 46).
54. Gjykata gjithashtu rikujton që parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve që ndërliidhen me interpretimin e gabuar të ligjit, para Gjykatës gjithashtu pretendon edhe shkelje të parimit të barazisë së palëve.
55. Përkitazi me këtë pretendim, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës vetëm i referohet këtij parimi dhe para Gjykatës nuk ka paraqitur asnjë argument në mbështetje të këtij pretendimi. Për pasojë, bazuar në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata nuk do të shqyrtojë më tej këtë pretendim (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI136/14, parashtrues: *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; dhe KI187/18 dhe 11/19, parashtrues *Muhamet Idrizi*, Aktgjykim i 29 korrikut 2019, paragrafi 73).
56. Prandaj në këto rrethana, dhe në bazë të asaj që u tha më lart, si dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore dhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore sa i përket shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 20 janar 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi